



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .08.2023

MBLEDHJA Nr. 42,
Datë 09.08.2023, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 09.08.2023, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 42 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 03.08.2023
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Korrik 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “SELCA ENERGJI” shpk për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC Selca
4. Mbi licencimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
5. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “HYDRO SETA” shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 5, datë 17.01.2019
6. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 31.03.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “HEC Tërfoja” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tërfoja”, me kapacitet të instaluar 1980 kW”, i ndryshuar

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI